ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT

Sipas Nenit 109 të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës se Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092

Një ankesë kundër: **KUVENDI KOMUNAL I PRIZRENIT**

Për Aktivitetin e Prokurimit Nr. i AP: **622-24-13570-5-1-1**

Sa i përket tenderit për **Rregullimi i rrugëve dhe trotuareve në lagjen dy korriku në Prizren. projekt dyvjeqar**

ANKESË

1. Identifikimi i ankuesit*

Shëno emrin e plotë të kompanisë suaj	**" ARCHI TIME " SH.P.K.**
NUI	**601705364**
Adresa	**Remzi Ademaj**
Vendi	**Prizren**
Kodi postar	**20000**
Numri Telefonit	
Emri i plotë i përfaqësuesit të kompanisë suaj	**Dashnor Ndrecaj**
Adresa elektronike	**architime.infrastructure@gmail.com**
Data e parashtrimit të ankesës	**26.03.2025**

**Ankues do të thotë një palë e interesuar për parashtrim të ankesës.*

2. Identifikimi i avokatit

Parashtruesi i ankesës mund ta parashtroj ankesën vetëm ose përmes avokatit të tij. Nëse ankesa parashtrohet përmes avokatit, atëherë duhet bashkangjitur autorizimin e përfaqësimit me PROKURË.

Shëno të dhënat si në vijim:

Emri i avokatit

Adresa e plotë

Numri i Telefonit

Numri i faks-it

Adresa elektronike

3. Të dhënat mbi aktivitetin e prokurimit

Shëno një përshkrim te shkurtër lidhur me datën dhe vendin në të cilën është publikuar " Njoftimi për Kontratë" apo "Njoftimi për konkurs te projektimit" dhe, nëse aplikohet "Njoftimi për dhënie të Kontratës" "Njoftimi për Rezultatet e Konkursit të Projektimit", apo "Njoftimi për anulim te aktivitetit te prokurimit", nëse aplikohet, afatin e fundit për dorëzimin e tenderit, datën dhe orën e fillimit të procesit për Hapjen e Tenderëve, si dhe kriteri për dhënie të kontratës:

Ankesa i përket grupeve:

Rregullimi i rrugëve dhe trotuareve në lagjen dy korriku në Prizren. projekt dyvjeqar

Njoftim për kontrate dt. 30.12.2024 në E-Prokurim

B54 Formulari standard per korrigjimin e gabimeve ne njoftimet e publikuara dt.17.01.2025

B54 Formulari standard per korrigjimin e gabimeve ne njoftimet e publikuara dt.03.02.2025

B54 Formulari standard per korrigjimin e gabimeve ne njoftimet e publikuara dt.06.02.2025

Lloji i Kontratës:Punë, Procedurë e Hapur, Kontratë me vlerë të madhe

Afati i fundit për dorëzimin e tenderit me dt.18.02.2025, ora 14:00

Pranimi i Proces Verbalit të Tenderit, dt.18.02.2025

Njoftim mbi vendimin e autoritetit kontraktues dt 12.03.2025

Kerkesë për qasje ne dokumente dt.13.03.2025

Kërkesa per Rishqyrtim dt.17.03.2025

Vendimi i AK në Kërkesën për Rishqyrtim dt.20.03.2025

Kriter për dhënien e Kontratës:Çmimi më i ulët

4. Procesi i Hapjes së tenderëve, *nëse aplikohet*

A keni marrë pjesë në procesin e Hapjes së tenderëve? Nëse po, specifikoni shkurtimisht ecurinë e procesit të Hapjes së Tenderëve.

Po ☐ **Jo** ☒

5. Njoftimi mbi Eliminimin e Tenderuesve, *nëse aplikohet*

A jeni njoftuar me shkrim lidhur me eliminimin tuaj nga pjesëmarrja e mëtutjeshme në aktivitetin e prokurimit ?

Po ☒ ***Jo*** ☐

6. Zgjidhja preliminare e mosmarrëveshjeve

A keni bërë kërkese për rishqyrtim pranë AK lidhur me arsyet e eliminimit tuaj?

Po ☒ **Jo** ☐

Nëse po, ofroni detaje mbi këtë fakt dhe bashkëngjit një kopje te vendimit te miratuar nga

AK gjate kontestit paraprak te zgjidhjes se mosmarrëveshjeve ne përputhje me nenin 108A te LPP-se.

Me dt.17.03.2025 ne kemi bërë Kërkesë për Rishqyrtim. Të bashkangjitur e gjeni Vendimin e AK per Kerkesën për Rishqyrtim.

7. Dispozitat e shkelura nga Autoriteti Kontraktues

Specifikoni dispozitën ose dispozitat e LPP-së që supozohet të jenë shkelur nga Autoriteti Kontraktues që nga momenti i publikimit të Njoftimit për Kontratë/Konkurs te Projektimit, dhe nëse aplikohet gjerë në përmbylljen e këtij aktiviteti të prokurimit me publikimin e Njoftimit për Dhënien e Kontratës apo Njoftimit për Rezultatet e Konkursit të Projektimit apo Njoftimit për Anulim.

Neni 1 - Qëllimi

Neni 6 - Ekonomiciteti dhe Efikasitet

Neni 7 - Barazia në Trajtim/ Jo-Diskriminimi

Neni 53 - Sigurmimi i informatave shtesë për kandidatët dhe tenderuesit

Neni 59 - Ekzaminimi, Vlerësimi dhe Krahasimi i Tenderëve
Neni 60 - Kriteret për Dhënien e Kontratës

Neni 64 - Dështmitë e kërkesave

Neni 69 - Aftësia Teknike dhe/ose Profesionale
Neni 72 - Dokumentacioni dhe informacioni shtesë
Neni 131 - Shkeljet e Ligjit nga Autoriteti Kontraktues.

*** Sipas Nenit 118 të LPP, OSHP-ja do të kthej tarifën tuaj nëse ankesa aprovohet si e bazuar. OSHP-ja mund të kërkoj një gjobë shtesë deri në 5,000 Euro në rastet kur OSHP-ja konstaton që të gjitha apo cilado nga pretendimet e parashtruara në ankesë kane qenë e rrejshme ose mashtruese.*

8. Deklaratë detale mbi faktet dhe argumentet

Përshkruani rrethanat faktike që përbëjnë supozimin për shkeljen e dispozitave të LPP-së. Ofroni deklaratë të qartë dhe të detajuar për faktet dhe argumentet të cilat mbështesin secilën bazë të ankesës tuaj.

Më dt.12.03.2025 është publikuar Njoftimi mbi Vendimin e AK-së, ku është rekomanduar për kontratë OE SEFERI-CO, kurse neve na është dërguar letra standarde për tenderues të pasuksesshëm. Gjithashtu në këtë letër AK ka bashkangjitur edhe disa letra të tjera të kontratave tona aktive që i kemi me Kuvendin Komunal të Prizrenit. Arsyja e bashkangjitjes së këtyre dokumenteve është e pa kuptim, kur asnjëra nga këto nuk ka të bëjë me këtë aktivitet të prokurimit dhe bashkangjitja e këtyre letrave në një Njoftim mbi Vendimin e Ak-së është dështmi e plotë që Kuvendi Komunal i Prizrenit, konkrektisht Drejtoria e Sherbimeve Publike në çdo

aktivitet të prokurimit qe ne ofertojmë përmes te njejtit komisioni vleresues (ku ky komision i ka kaluar edhe kompetencat e veta) ka tendeca personale dhe me këtë vazhdimisht po tenton të na dëmtojë imazhin e kompanisë sonë të cilin e kemi ndërtuar tash e sa vite. Por për këtë dëmtim të imazhit të kompanisë sonë jemi të detyruar të vazhdojmë procedurën ligjore ne institucionet tjera kompetente.

Të bashkangjitur e gjeni kete dokument skandaloz qe Ak e ka quajtur Njoftim mbi Vendimin e Autoritetit Kontraktues-B58.

Pasi që kemi kërkuar Qasje në Dokumete dt.13.03.2024 nga Autoriteti Kontraktues të Operatorit Ekonomik SEFERI-CO. Ne nuk kemi mundur te kemi Qasje të plotë në Dokumentet e OE-së se rekomanduar për kontratë nga AK sespe sipas AK-së OE SEFERI-CO e ka të plotesuar Aneksin 3, edhe pse në Rregulloren nr.002/2024 per Plotesimin edhe ndryshimin e rregullores nr.001/2022 per Prokurim Publik, konkretisht Ndryshim-Plotesimi i Rregullores Nr.001/2022 për Prokurim Publik e cila ka hyrë në fuçi më datë 11.11.2024, në Nenin 7 të kësaj rregullores mbi Informatat sekrete afariste dhe qasja në dokumentacion, gjegjësisht nën-neni 7.6.5 (citat):

"Jo të gjitha dokumentet e specifikuara nga Autoriteti Kontraktues në Dosjen e Tenderit dhe

Njoftimin për Kontratë në përputhje me nenin 68 dhe 69 të LPP-së, mund të klasifikohen

si informata sekrete afariste. Dokumentet e specifikuara sipas nenit 68 e 69 të LPP e të cilat

janë publike në bazë të këtij ligji dhe legjislacionit tjetër përkatës në fuqi, nuk mund të

klasifikohen si informata sekrete afariste."

Andaj në bazë të kësaj Autoriteti Kontraktues na ka diskriminuar duke mos të na dhënë çasje në dokumentet e OE SEFERI-Co, duke na lënë në dyshime që ky i fundit ka mungesa në Kërkesat e përshtatshmërisë profesionale, Kërkesat mbi gjendjen ekonomike dhe financiare si dhe në Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe profesionale.

Çasje kemi pasur vetëm në Paramasë, ku mbas kontrollimit të Çmimeve në paramasën me anë të cilës OE SEFERI-CO ka ofertuar kemi hasur në disa cmime jo-normalisht te uleta te cilat jane te papranusheshme ne krahasim me objektin e kontrates dhe OE ne fjale ka dorezur nje tender te pazbatueshem.

Pasi që tek poz. 1.4.10, ky një pozicion mjaft i rëndësishëm i këtij projekti ku AK në dosje të tenderit posaqërisht për këtë pozicion ka kërkuar Kushte të Veqanta dhe Specifikimet Teknike, ku per realizimin e ketij pozicioni kerkohen standarde te veqanta te cilat e bejne kete produkt edhe me te shtrenjte, kurse OE SEFERI-CO ka ofertuar me një çmim qesharak dhe skanadloz që nuk korrespodon me tregun tonë.

"Poz. 1.4.10 Furnizimi me pllaka i shtigjeve të ecjes për persona të verbër me pllaka 40 x 40 x 6 cm ngjyrë e verdhë bazuar në standardet dhe alfabetin për përsona të verbër. Llog në m' të vendosjes së tyre në

trotuare.

Prodhuesi te jete i certifikuar sipas ISO 9001/2015 (Sistemi per menaxhimin e cilesise) per system hermetik te makinerise prodhuese.

Produkti te plotesoj standardet ne vazhdim: EC (Declaration of Conformity) Produkti te posedoj shenjen CE ne perputhje me direktivat per CPD(Construction Product Directive) sipas EN 13748-2. Çmimi i ofertuar nga OE SEFERI-CO 1m2 x 5 €

Nga përvoja jonë dhe nga ofertat që i kemi marrë posaqërisht për këtë pozicion për këtë aktivitet të prokurimit Furnizimi dhe Vendosja e pllakave te shtigjeve për persona te verber nuk mund të realizohet me këtë çmim.

E ritheksojmë joprofesionalizimin e AK-së për këtë aktivitet të prokurimit, ku pa i marrur të gjitha faktet dhe detajet për këto çmime dhe pa hulumtuar tregun ata kanë shpallur tenderues te suksesshem nje OE jo serioz, me çmime te pazbatueshme i cili nuk mund ta realizojë këtë pozicion me çmimin me të cilin ka ofertuar.

Sipas Nenit 41 te Rregullores Nr.001_2022 per prokurim publik Nen-neni 41.1 thote qe Koncepti I tenderit jo-normalisht te ulet I referohet tendereve qe ne shikim te pare duken si jo te besueshme nese krahasohet me objektin e kontrates dhe ne perputhje me rrethanat dhe qe ka gjasa per nje ndikim negative ne performance te implementimit te kontrates.

Nga kjo rredh qe edhe OE I shperblyer me kontrate ne kete rast me Listen e Cmimeve me ane te ciles ka ofertuar ne kete aktivitet te prokurimit do te kete nje ndikim negative ne performancen e impelentimit te kontrates dhe si te tille ka dorezuar nje tender te pazbatueshem, pasi qe me cmimin me te cilin ka ofertuar në Poz.1.4.10 eshte skandaloze dhe verehen qarte qe ky OE nuk eshte serioz ne realizimin e pozicioneve sic jane te kerkuara ne kete kontrate.

Gjithashtu në bazë të çmimit që ka ofertuar për poz. 1.4.10 dyshojmë që OE SEFERI-CO I ka plotesuar kushtet dhe standardet që janë kërkuar për këto pllaka.

Andaj AK vendimin për tenderues të sukseshëm duhet ta anulojë dhe aktivitetin e prokurimit ta kthejë në ri-vlerësim dhe të veprojë sipas Rregulloreve dhe Ligjeve në fuçi.

Sipas DT Tenderi qe do të perzgjidhet i përgjegjshëm është ai me Çmim më të ulët kurse Operatori Ekonomik i shpallur nga Autoriteti Kontraktues si tenderues i suksesshëm nuk e plotëson këtë

kërkesë pas që ai është 108,938.52 € më i shtrenjtë se ne. Me këtë AK ka shkelur Nenin 6 – Ekonomiciteti dhe Efikasitet.

Gjithashtu në letrën e Autoritetit Kontraktues "*Njoftim mbi vendimin e autoritetit kontraktues*":

Arsyeja e 1-rë e pretenduar nga AK për eleminimin tonë:

Ju mungojnë :

3.Operatori ekonomik duhet të ofroj dëshmi të kënaqshme Autoritetit Kontraktues se qarkullimi i OE gjatë tri viteve të shkuara (duke filluar nga koha e publikimit të këtij njoftimi) ka qenë prej jo më pak se 4,800,000.00 €.

Evidenca 1 Pasqyrat e qarkullimit financiare të kompanisë, të shoqëruar me qarkullim financiar nga banka për tri vitet e shkuara apo deklaratat e tatimeve vjetore të dorëzuara në Administratën Tatimore të Kosovës. **(mungon qarkullimi financiar apo nuk e plotëson kerkesen e Ak te vendosur në Dt dhe NJK).**

Pergjigje ne arsyen e 1-rë të pretenduar nga AK per eleminimin tone:

Arsyetimi i AK-es eshte i pabazuar dhe joprofesional. Së pari shikone fjalinë qe e ka formuluar për eliminimin tonë, ku AK thotë *"mungon qarkullimi financiar apo nuk e plotëson kerkesen e Ak te vendosur në Dt dhe NJK"* duke mos e ditur as AK për çfarë arsyje po na elinimon sepse na mungon qarkullimi financiar apo nuk e plotesojmë kerkesen?!

Me këtë ne e dëshmojmë qe AK në këtë rast në mënyrë tendecioze dëshiron të na eliminojë neve dhe te na shpallë si tenderues të pa suksesshem pa e kontrolluar fare dokumentacionin tonë.

Prapë se prapë ne e dëshmojmë që në dokumentacionin tonë që kemi paraqitur ne folderat me nr. **04. 1 CD 2020-2023 PCG** dhe **04.2 CD 2020-2023 Archi Time** ne formatin PDF ne e kemi të plotësuar kërkesë e AK sipas DT dhe NJK.

Te bashkangjitur ne ANEKSI 1 i gjeni dokumentacionet e qarkullimit financiar te cilat i kemi paraqitur edhe ne fazen e ofertimit.

Arsyeja e 2-të e pretenduar nga AK për eleminimin tonë:

b) Inxhinieri i Ndertimtarise – Drejtimi Infrastruktur Rrugore min. 3 vit përvoj pune te caktohet me vendim nga OE si Udheheqes i Punishtes.

(mungojnë dëshmitë për Ing e kerkuar ne dt dhe njk sipas kerkeses se AK, GOE ne fjale ka cekur nje udheheqes te punishtes infrastrukture rrugore zt.DK mirepo ky vendim nuk eshte per kete projekt ne fjale po eshte per nje proejkt tjeter "Ndertimi i rrugeve dhe kanalizimeve ne fshatin Krajk projekt tre vjeqar me nr.prokurimit 622-24-13325-5-1-1)

Pergjigje ne arsyen e 2-të të pretenduar nga AK per eleminimin tone:

Arsyetimi i AK-es eshte i pabazuar, sepse në Listen e Stafit Profesional ne kemi paraqitur Ing.z.DK qe eshte Udheheqes i Punishtes per aktivitetin e prokurimit në fjalë, kurse tek Vendimi ka ndodhur një lëshim Teknik ku titulli dhe nr. i prokurimit ka mbetur i një aktiviteti tjetër të prokurimit i cili ka qenë më datë 11.02.2025, kurse Vendimi per Udheheqes te punishtes per kete aktivitet te prokurimit eshte i dorezuar me date 13.02.2025, dmth 2 ditë mbas perfundimit te Aktivitetit te Prokurimit "Ndertimi i rrugeve dhe kanalizimeve ne fshatin Krajk projekt tre vjeqar me nr.prokurimit 622-24-13325-5-1-1". Gjithashtu ne kontraten e tij ceket shum kjartë sidomos ne neni III te Marreveshjes se Bashkepunimit që "Për angazhim dhe kryerje të punëve z.DEFRIM KABASHI është i obliguar të bëjë udhëheqjen e punimeve (në këtë sektor), si dhe të përpiloj raporte të rregullta profesionale."

Por AK ka mundur të na kërkojnë me anë të letrës sqarim të tenderit/sjellja e dëshmive, konform Nenit 72 te LPP dhe Rregullores nr.001/2023 te Prokurimit Publik pikës 10.

Te bashkangjitur ne ANEKSIN 2 i gjeni të gjitha dokumentet për Inxhinierin ne fjalë.

Gjithashtu te bashkangjitur ne ANEKSIN 2.1 gjeni edhe Interprentimin e KRPP për një pyetje rreth gabimeve te dokumenteve qe nje OE mund ti paraqet gjate dorezimit te nje oferte dhe se si keto dokumentet duhet te mirren parasysh dhe se si te veprohet ne keto faza.

<u>Arsyeja e 3-të e pretenduar nga AK për eleminimin tonë:</u>

Kërkesa 3. Kompania duhet të posedoj 1 Ekspert SSHP, per mbrojtje nga zjarri nga AME.

Deshmija 3 Kontrata ose kontrata e bashkepunimit per ekspertin bashk me cv, diplomen per kualifikim dhe certifikata e kerkuar. Ekspert SSHP, dhe mbrojtje nga zjarri nga AME.

(mungojne deshmit per Ing e kerkuar ne dt dhe njk sipas kerkeses se Ak, Masteri i menaxhimit te emergjencave z.RF ne CV e prezantuar ne dosjen e tenderit nuk eshte e nenshkruar nga vet Ing sic eshte kerkuar ne dosjen e Ak, andaj nuk e ploteson kriterin sipas Dosjes se tenderit)

Pergjigje ne arsyen e 3-të të pretenduar nga AK per eleminimin tone:

Arsyetimi i AK-es eshte i pabazuar dhe i pa vertetë sepse tek Deshmia 3 Kerkohet Kontrata ose kontrata e bashkepunimit per ekspertin bashk me **cv**, diplomen per kualifikim dhe certifikata e kerkuar. Ekspert SSHP, dhe mbrojtje nga zjarri nga AME. Dmth kerkohet vetem CV dhe jo te jete e nenshkruar nga Ing ne kete rast.

Atehere Dokumentacioni jone ne kete rast eshte sipas kerkeses se AK qe eshte kerkuar ne DtT dhe NJK, dmth ky kriter eshte plotesuar konform kerkeses ne DT dhe NJK.

Arsyeja e 4-të e pretenduar nga AK për eleminimin tonë:

Kerkesa 6. OE duhet te Posedoj Licenc Asfalti valide apo marreveshje te skanuar nga origjinali per projektin e cekur.

Deshmija 6. Licenc Asfalti valide, apo marreveshje per projektin e cekur. (mungon deshmia e kerkuar sipas kerkeses se AK).

Pergjigje ne arsyen e 4-të të pretenduar nga AK per eleminimin tone:

Arsyetimi i AK-es eshte i pabazuar dhe i pa vertetë, sepse ne dokumentacioni tone konkretisht ne follderin me titull 10.Marreveshja per Asfalt ne kemi paraqitur Marreveshjen per Furnizim me Asfalt me kompanine e cila ka Licence te Asfaltit Valide.

Te bashkangjitur ne ANEKSIN 3 i gjeni dokumentet (marreveshjen dhe Licencen valide te asfaltit) te cilat i kemi ngarkuar gjate ofertimit tonë.

Me ane te kësaj e vërejmë prapë tendencën e AK për të na eliminuar pa e kontrolluar fare dokumentacionin tonë.

Arsyeja e 5-të e pretenduar nga AK për eleminimin tonë:

Kërkesa 8. Prodhuesi i pllakave per hapesira te jashtme te jete i certifikuar sipas ISO 9001:2015 (Sistemi per menaxhimin e cilesise) per system hermetic te makinerise prodhuese. Produkti te plotesoj standardet ne vazhdim EC ose DOP (declaration of Conformity). Produkti te posedoj shenjejn CE ne perputhje me direktivat per CPD (Construction Product Directive) dhe EN 13748-2.

Deshmija 8. Katalogu i produkteve konform specifikave te prezantuara ne proejkt dhe te ofroj certifikatat e kualitetit te materilait. OE duhet te ofroje Marrevshje me prodhuesin ose dilerin e autorizuar per furnizimin e produkteve per pozicionin e pllakave per hapesira te jashtme.

(mungon deshmia e kerkuar sipas kerkeses se AK te kerkuar ne dt dhe njk, prodhuesi i pllakave per hapesiren e jashteme duhet te jete i Certifikuar sipas 9001-2015)

Pergjigje ne arsyen e 5-të të pretenduar nga AK per eleminimin tone:

Arsyetimi i AK-es eshte i pabazuar dhe i pa vertetë, sepse ne dokumentacioni tone konkretisht ne follderin me titull 11.Dokumentet per pllakat kemi paraqitur edhe Certifikaten 9001:2015 te prodhuesit të pllakave.

Nga kjo rrjedhë qe AK eshte joprofesionale gjatë kontrollimit te dokumentacionit, sepse per nje dokument qe cilin e kemi dorezuar gjate ofertes tone Ak pretendon qe neve ky dokument na mungon duke na eliminuar pa arsyje ne kete aktivitet te prokurimit.

Te bashkangjitur ne ANEKSIN 4 e gjeni Certifikaten 9001:2015 te prodhuesit te pllakave te cilen e theksojme edhe njehere qe e kemi paraqitur gjate ofertimit tone ne kete aktivitet te prokurimit.

Arsyeja e 6-të e pretenduar nga AK për eleminimin tonë:

Kerkesa 10. Ne Aneksit 7 eshte ngrite tabelari i pajisjeve teknike te cilat jane te detyrueshme per OE pjesemarres ne kete projekt per te qene oferte e pergjegjshme.

(mungojne deshmite e kerkuara per pajisjet teknike te kerkuara ne dosje te tendrit dhe njoftim per kontrate

Pergjigje ne arsyen e pretenduar nga AK-es per eleminimin tone:

Arsyetimi i AK-es eshte i pabazuar sepse neve nuk na mungojnë këto pajisje te cilat i ka listuat dhe të tillat mund të na kërkojnë me anë të letrës sqarim të tenderit/sjellja e dëshmive, konform Nenit 72 te LPP dhe Rregullores nr.001/2023 te Prokurimit Publik pikës 10, ashtu siç citohet edhe në Vendimin e OSHP-së me nr.2024/0255. Te gjitha keto pajisje qe Ak pretendon qe neve na mungojne jane te paraqitura edhe ne Listen e Makinerise te cilen e kemi paraqitur ne fazen e ofertimit.

Te bashkangjitur ne ANEKSIN 5 e gjeni Listen E Pajisjeve/Makinerive te cilen e kemi dorezuar gjate fazes se ofertimit.

Si permbledhje e fakteve dhe argumenteve vlen te theksohet se AK-es ka bere shkelje te renda te LPPse, perkatesisht po tenton me vendime arbitrate te demtoj buxhetin e Komunës së Prizrenit me rreth 108,938.52 €, duke rekomanduar për dhënie të kontratës një ofertë të një Operatori Ekonomik me çmim **më të lartë edhe pse Kriteri për dhënie të Kontratë është Çmimi më i ulët.**

Andaj, kërkojmë nga Autoriteti Kontraktues që të bëjë anulimin e vendimit per vendimin e tenderuesit të suksesshem i cili vendim eshte bere ne shkelje te rende te LPP-se dhe Ligjeve ne fuqi dhe kete lende ta ktheje ne rivleresim duke respektuar dispozitat e LPP-s. I rezervojme te gjitha te drejtat tona ligjore qe te mbahemi te informuar ne te gjitha fazat e ketij procesi.

9. Dëmet materiale

Përshkruaj mënyrën se si shkelja e supozuar i ka shkaktuar ose kërcënohet t'i shkaktojë dëme materiale parashtruesit të ankesës, në rast se përfshini pretendime për kompensim.

Me vendimet e tilla arbitrare po tentohet te demtohet buxheti i Komunës së Prizrenit ne vlere prej 108,938.52 Euro dhe gjithashtu kompanive tona i rrezikon ti shkaktoje deme te medha financiare dhe gjithashtu me kete vendim ka demtuar imazhin dhe reputacionin e kompanive tona.

10. Lista e dokumenteve (dëshmive) të bashkangjitura

Nëse aplikohet, bashkëngjitni Ankesës dokumentet e renditura më poshtë:

a) *një kopje të publikimit të "Njoftimit për Kontratë" apo "Njoftimit për Konkurs të Projektimit.*
b) *një kopje të publikimit për "Njoftimin e Dhënies së Kontratës" apo "Njoftimin për Rezultatet e Konkursit të Projektimit" apo "Njoftimit për Anulim".*
c) *një kopje të letrës së eliminimit të tenderuesit/kandidatit/ letrës se tenderuesit të pasuksesshëm/ letrës për mos para-kualifikim.*
d) *një kopje të procesverbalit të hapjes publike të tenderëve, nëse aplikohet,*
e) *bashkëngjit një kopje te vendimit te miratuar nga AK gjate kontekstit paraprak te zgjidhjes se mosmarrëveshjeve ne përputhje me nenin 108A te LPP-se,*
f) *Dëshminë e pagesës së tarifës së ankimit në përputhje me nenin 118 të LPP-se, dhe*
g) *të gjitha korrespondencat e juaja me autoritetin kontraktues duke përfshirë e-mailat si dhe çdo informatë të shkruar që ka të bëjë me këtë aktivitet prokurimi, si dhe me secilin pretendim të paraqitur në ankesë.*

****Sipas Nenit 111.2 të LPP, Parashtruesi i ankesës, origjinalin e ankesës do t'ia dorëzojë OSHP-së dhe njëkohësisht një kopje do t'ia dërgojë në mënyrën më të shpejtë të mundshme Autoritetit Kontraktues.*